



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

PËR

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.111, DATË 23.2.2018, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FONDIT  
SOCIAL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në Vendimin Nr.111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1. shtohet pika 1,1 me këtë përmbajtje:

"1.1 Fondi Social krijohet si program buxhetor më vete në çdo Njësi të Vetëqeverisjes Vendore sipas një kodifikimi të përcaktuar në buxhetin vendor. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përcaktojnë produktet buxhetore brenda programit të Fondit Social bazuar në qëllimin e funksionimit të tij në nivel vendor."

2.Në pikën 2, shkronja "b", ndryshohet si më poshtë vijon:

"b. fondet nga buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të parashikuara në programin e buxhetit të Fondit Social".

3.Pikat 4.1 dhe 4.3, ndryshohen si më poshtë vijon:

"4.1 Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson nevojat për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor dhe harton planin social vendor duke identifikuar ato shërbime që mbeten të pafinancuara bazuar në programin buxhetor afatmesëm."

4.3 Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat u transferohen njësisë të vetëqeverisjes vendore, ku

funksionojnë këto shërbime si pjesë e programit të Fondit Social në nivel vendor. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore administrojnë fondet e transferuara në programin e Fondit Social për realizimin e produkteve dhe shërbimeve të planifikuara prej tyre në periudha 3 vjeçare.”

4. Ngarkohet Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Ministria përgjegjëse për pushtetin vendor dhe Ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E M I N I S T R I**

**ED I R A M A**